



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.192/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ZL.Anr.192/2025 datë 11.10.2025.

II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1500 € (njëmijë e pesëqind Euro).

III. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Detyrohet që gjobën e shqiptuar si në pikën -II të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë Më 10.10.2025 rreth orës 13:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë vërejtur se: kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës kryetar të Komunës së Prishtinës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, z Trim Sylja, nga facebook dhe instagram faqja e tij ka shpërndarë video ku shihet në ambientet e brendshme të Pallatit të Rinisë në Prishtinë duke bërë fushatë për vete dhe partinë të cilën e përfaqëson. Me këtë veprim, kandidati dhe subjekti politik PDK, ka shkelur dispozitat e nenit 36 të LZP-së duke përdorur resurset publike, Pallatin e Rinisë në Prishtinë, pronë e Ndërmarrjes Publike Lokale

"Pallati i Rinisë" SH.A me qëllim të fitimit të votave. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si dëshmi ka bashkangjitur provat; <https://www.facebook.com/share/r/1G2wMifzgP/> (linku nga facebook faqja)

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik PDK thekson se kjo ankesë është e pabazë për arsye se videoja nuk është xhiruar brenda Pallatit të Rinisë, por jashtë tij, ndërtesa shfaqet vetëm në sfond, në momentin kur kandidati ynë thotë se në pallat duhet të ketë hapësirë për teknologji dhe bibliotekë është vetëm një ilustrim vizual se si duhet të duket një e ardhme e tillë, pamjet nuk janë realizuar brenda objektit. Prandaj, bazuar në nenin 118 propozojnë i PZAP-it i që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, pasi ankuesi nuk ka arritur që të argumentoj përgjegjësinë e PDK, të mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, z Trim Sylja, nga facebooku dhe instagram faqja e tij ka shpërndarë video ku shihet në ambientet e brendshme të Pallatit të Rinisë në Prishtinë duke bërë fushatë për vete dhe partinë të cilën e përfaqëson.

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur dispozitën e nenit 36 paragrafi 3, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*.

Përveç kësaj, me nenin 5 par 6, Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, është përcaktuar se: *"Subjekteve politike të certifikuara u ndalohet shfrytëzimi i burimeve ose resurseve të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni publik"*. PZAP vlerëson se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, Trim Sylja, ka shkel rregullat e sipërcituara, kjo pasi që ka përdorë objektin publik ambientet e brendshme dhe të jashtme të Pallatit të Rinisë në Prishtinë duke bërë fushatë për vete dhe partinë të cilën e përfaqëson me qëllim të promovimit të kandidaturës së tij, për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e Trim Sylës kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga subjekti politik PDK, bien ndesh me dispozitën e nenit 5 par 6, Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar dhe nenit 36 paragrafi 3 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që i njëjti me këto veprime-kërkesa ndaj qytetarëve të Prishtinës ka pasur qëllim të vetëm përfitimin e votave në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor të kësaj natyre. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj bërja e fushatës zgjedhore e kandidati për kuvend komunal, duke e shfrytëzuar objektin publik, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 par 6, Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar nenit 36 paragrafi 3 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.192/2025 më datën 13.10.2025

Kryesuese e Panelit,
Violeta Hysaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.